



Ambasada Britanike
Tiranë

qendra për
transparencë
dhe **informim**
qtil të lirë

SONDAZH PROMOVIMI I GJYQTAREVE DHE SISTEMI I PIKEZIMIT

KORRUPSIONI, PAVARESIA DHE INTEGRITETI NE
SISTEMIN E DREJTESISE

*Projekt i Qendra për Transparencën dhe Informimin e Lirë
Financuar nga Ambasada Britanike*

Të dhëna bazike të anketimit

- **Koha:** shkurt-mars 2012
- **Fokusi:** 60% e gjykatave të shkallës së parë në të gjithë vendin. Gjykatësit janë nga 14 gjykata (23 që janë gjithsej).
- **Kampioni i përzgjedhur:** 58 % e gjyqtarëve (177 / 305) ose 47 % e 380 gjyqtarëve që janë në total në dy shkallët e gjyqësorit.
- **Karakteristika të kampionit:** Gjykata nga të gjitha zonat dhe kategoritë e qyteteve (nga gjykatat e vogla dhe në periferi me vetëm 4 gjykatës e deri tek gjykata e Tiranës me rreth 67 gjykatës).

Objektiva të anketimit

- **matja e impaktit** të reformës në promovimin e gjyqtarëve ndërmarrë nga KLD;
- **matja e perceptimit** të gjyqësorit për vetë gjyqësorin;
- **matja e perceptimit** të gjyqësorit për pushtetet dhe institucionet e tjera.

Qëllimet

- **orientimi i reformës** në gjyqësor në pajtim me nevojat e sistemit,
- **forcimi i besimit** të qytetarëve dhe institucioneve te sistemi gjyqësor dhe gjyqtarët,
- pjesëmarrja e gjyqtarëve **në debatin publik për reformin e sistemit gjyqësor** dhe institucioneve të tjera.

Të dhëna më të detajuara të kampionit

Profili i punësimit në gjykatë

- rreth **35 %** e gjykatësve të anketuar trajtojnë çështje penale,
- rreth **45 %** zhvillojnë çështje civile,
- pjesa e mbetur, rreth **19 %**, nuk e gjejnë veten të ndarë mes dy gjykimeve.

Të dhëna më të detajuara të kampionit

Mosha

Në përgjithësi janë në moshë të re apo mesatare

- **20 %** janë 31-35 vjeç,
- **18 %** janë 36-40 vjeç,
- **24 %** e tyre janë në grupmoshën 41-45 vjeç,
- mbi 50 vjeç janë **16 %**,
- nën 30 vjeç janë **8 %**.

Të dhëna më të detajuara të kampionit

- rreth **60 %** e gjykatësve janë meshkuj
- rreth **40 %** janë femra.

Të dhëna më të detajuara të kampionit

Edukimi

- rreth **64 %** vijnë direkt nga fakulteti i Drejtësisë
- pjesë tjetër, rreth **36 %** vijnë nga Magjistratura

Të dhëna më të detajuara të kampionit

Përvojat e puësimit

Gjykatësit e anketuar kanë pasur përvoja të ndryshme punësimi më parë si në administratën civile, avokati, prokurori etj:

- rreth **72 %** e tyre kanë përvoja që kanë lidhje me punën e gjyqtarit, pra brenda sistemit,
- rreth **28 %** e tyre kanë ardhur prej fushave të tjera të punësimit.

Vlerësimi për sistemin gjyqësor

Të anketuarit kanë dhënë këto përgjigje:

- rreth **25 %**: gjyqësori në Shqipëri është i korruptuar ose qëndrojnë neutral,
- rreth **58 %**: ky është vetëm perceptim,
- rreth **18 %**: gjyqësori nuk është i korruptuar.

Pavarësia e sistemit

- **50 %** është pjesërisht i pavarur nga politika,
- **7 %** është i varur nga politika,
- **33 %** është i pavarur prej saj,
- **10 %** nuk janë shprehur.

Kërkesa për favorizim në procesin gjyqësor

- rreth **60 %** deklaruan se nuk kanë pasur oferta për t'u paguar në këmbim të ndryshimit të vendimit të gjyqit si favorizim për një palë,
- rreth **30 %** kanë pasur oferta të tilla,
- rreth **10 %** kanë hezituar të përgjigjen.

Ndërhyrjet për favorizim prej të tjerëve

- **5 %** kanë thënë se kanë pasur ndërhyrje nga zyrtarët e qeverisë,
- **4 %** nga anëtarë të Parlamentit,
- **4 %** nga zyrtarë të Presidencës,
- **31 %** nga avokatët,
- **16 %** nga zyrtarë të pushtetit lokal,
- **40 %** nga individë të tjerë.

Pse dështojnë/proceset gjyqësore

- **28 %** nga mungesa apo ndërhyrjet e avokatëve
- **23 %** nga mugesa e dëshmitarëve
- **20 %** nga mungesat në ligjislacion
- **10 %** nga mungesa e infrastrukturës
- **8 %** nga mungesa në profesionalizmin e prokurorëve
- **3 %** nga mungesa në profesionalizmin e gjyqtarëve
- **8 %** nga arësyet tjetra

Kushtet e punës

- **72 %** e gjyqtarëve të pakënaqur me pagën,
- **14 %** paksa të kënaqur,
- **7 %** janë të kënaqur.

Siguria në punë

- **38 %** shprehen se janë të pasigurtë në vendin e punës,
- **18 %** të sigurtë,
- **37 %** paksa të sigurtë.

Vlerësimi për institucionet e drejtësisë

Për punën e KLD

- **45 %** mjaftueshëm,
- **36 %** mirë,
- **10 %** keq,
- **9 %** neutral.

Vlerësimi për institucionet e drejtësisë

Për Ministrinë e Drejtësisë

- **38 %** deklarojnë ka punuar mirë,
- **45 %** deklarojnë ka punuar mjaftueshëm,
- **7 %** ka punuar keq.

Vlerësimi për institucionet e drejtësisë:

Për Konferencën Gjyqësore gjyqtarët e shkallës së parë kanë dhënë këto vlerësime:

- **21 %** negativ
- **25 %** mirë
- **46 %** mjaftueshëm

Vlerësimi për korruptionin

Për pyetjen

“A keni paguar kur keni marrë një shërbim mjekësor?“:

-24 % PO

-45 % JO

-20 % NDONJËHERE

-11% NEUTRAL

Vlerësimi për korruptionin

Për pyetjen

“A keni paguar kur keni marrë një shërbim nga administrata publike që jepet pa pagesë”:

8 % VAZHDIMISHT

19 % NDONJËHERË

64 % ASNJËHERË

Vlerësimi për shoqërinë civile

Gjyqtarët kanë dhënë këto mendime:

- **10 %** mendojnë se shoqëria civile e ka ndihmuar gjyqësorin,
- **34 %** mendojnë se e ka ndihmuar pak
- **45 %** shoqëria civile nuk ka qënë aspak ndihmë për gjyqësorin.

Vlerësimi për median

Për median gjyqtarët shprehen:

- **14 %** se është mbështetje për ta,
- **32 %** se ajo është presion,
- **44 %** media është thjesht një burim informimi.

Disa përfundime

- Të anketuarit thonë në një numër të konsiderueshëm rastesh se kriteri i vjetësisë në punë do të penalizonte nga promovimi gjyqtarët që kanë mbaruar magjistraturën. Duke patur parasysh se ky kriter merr 100 pikë dhe magjistratët që punojnë në gjykatë janë në mazhorancë mes moshës 30-40 vjeç.
- Gjyqtarët janë kritikë ndaj sistemit të drejtësisë. Ata mendojnë në shifra të konsiderueshme se drejtësia është e korruptuar dhe ka mungesë integriteti.
- Gjyqtarët janë joshur në mënyrë të konsiderueshme për të favorizuar një palë në procesin gjyqësor

Disa përfundime

- Ndërhyrjet më të mëdha me qëllim ndikimin e vendimit të gjykatës vijnë nga avokatët dhe zyrtarë apo drejtues të pushtetit lokal. Në Tiranë kjo ndërhyrje është më e madhe nga deputetë dhe zyrtarë të lartë. Edhe pse e vogël shifra që paraqet ndërhyrjen e Presidencës është e konsiderueshme dhe mjaft e dëmshme për shkak të konfliktit të interesit dhe prodhimit të një përqindjeje edhe pse të vogël nga një grup mjaft i vogël zyrtarësh.
- Gjyqtarët rendisin si shkaktar kryesor të dështimit të proceseve apo zgjatjes së tyre mungesën e dëshmitarëve në gjyq dhe mungesën e avokatëve. Po ashtu një vend të konsiderueshëm zënë edhe arsyet që lidhen me boshllëqe ligjore.

Disa përfundime

- Gjyqtarët mendojnë se niveli i gjykimit është më i mirë në shkallën e parë dhe më pas përkeqësohet në shkallën e dytë për të pësuar një ngritje të lehtë në Gjykatën e Lartë.
- Ndër institucionet e drejtësisë gjyqtarët kanë zgjedhur si më efektivin Ministrinë e Drejtësisë për të vazhduar më pas me KLD dhe në fund me Konferencën Gjyqësore.
- Gjyqtarët vetë janë shpesh pre e korruptionit në shërbimet publike ku ata paguajnë.

Propozime

- Nevojitet një fushatë informimi për gjyqtarët lidhur me sistemin e ri të promovimit dhe vecmas të procedurave. Një kënd i vecantë në faqen e KLD-së, Ministrisë së Drejtësisë dhe Gjykatave si dhe raunde të informimit në gjykatat e ndryshme të vendit do të shërbnin për njohjen më të mirë të sistemit të pikëzimet etj.
- Është i nevojshëm rishikimi i formulës se ndarjes se pikeve ne sistemin e pikëzimit pas një konsultimi me të gjerë me një numër sa më të madh gjykatësish ose përfaqësues të tyre si shoqatat e gjyqtarëve.

Propozime

Propozimet që vijnë nga gjyqtarët kanë të bëjnë kryesisht me:

- a. përfshirjen në sistemin e pikëzimit të cilësisë së gjykimit, volumin e punës së gjyqtarit ose sasia e gjykimeve, shpejtësia e gjykimit, lloji i çështjeve të trajtuar nga gjyqtarët, niveli i arysetimit të vendimit gjyqësor; mungesa e masave disiplinore.
- por ka edhe propozime të tjera më të rralla por që mund të përfshihen në debat si etika e gjyqtarëve, verifikimi i pasurisë personale, solemniteti në gjykim.
- b. rregullimin e raporteve mes pikëve veçmas ato që i përkasin vjetërsisë në punë dhe punës akademike dhe shkencore. Propozimet janë si vijon; të ulet pikëzimi për shkak të vjetërsisë në punë pasi penalizon nga promovimi gjyqtarët me magjistraturë; veprimtaria shkencore të marrë më pak pikë për shkak se kjo lloj veprimtarie kërkon impenjim dhe rëndon mbi përkushtimin e gjyqtarit në punën e tij të përditshme;

Propozime

- Vendosja në eficencë e ndryshimeve mbi ligjin e avokatisë
- Krijimi i një strukture e cila bën të mundur frekuentimin e dëshmitarëve në gjyqe.
- Është e domdososhme të evidentohen rastet ku gjyqtarët mendojnë se ka boshllëqe ligjore për të rishikuar ligje të ndryshme.



Ambasada Britanike
Tiranë



SONDAZH PROMOVIMI I GJYQTAREVE DHE SISTEMI I PIKEZIMIT

KORRUPSIONI, PAVARESIA DHE INTEGRITETI NE
SISTEMIN E DREJTESISE

*Projekt i Qendra për Transparencën dhe Informimin e Lirë
Financuar nga Ambasada Britanike*